



VENDIM

Nr.51 Datë 03 .05.2013

**PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVË PËR MODIFIKIMIN E LICENSËS
SË PRODHIMIT DHE TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE
TË SHOQËRISË “HEC-LANABREGAS” SH.A**

Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit”, nenit 15 të “Rregullores për procedurat e licensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, dhe nenit 18 pika 1, gërma “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin Nr. 21, datë 18.03.2009, të Bordit të Komisionerëve, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 03 .05.2013, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë Ujesjelles Kanalizime, Tirane, sh.a për modifikim të licensës së prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike të shoqërisë Hec Lanabregas sh.a, dhe informacionin e Drejtorisë së Licensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatoi se:

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “Hec-Lanabregas” sh.a plotëson kërkesat e “Rregullores së procedurave të licensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licensave”, si më poshtë:

- **Neni 15, pika 4, germa “a”:**
Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licensës. (është plotësuar tërësisht)
- **Neni 15, pika 4, germa “b”:**
Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licensuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licensë. (është plotësuar tërësisht)

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për modifikimin e liçensës së shoqërisë “Hec Lanabregas”sh.a
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Sokol RAMADANI

Ne mungese dhe me porosi

Entela SHEHAJ